



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 548/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Safete Hadërgjonaj – Deputete e Kuvendit të Kosovës, dega në Deçan për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, LDK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, me datë 03.11.2013 në ora 16:00 në Deçan në qendrën e votimit nr.0101C, deputetja e Kuvendit të Kosovës Safete Hadërgjonaj e ka kërcënuar verbalisht koordinatoren e vëzhguesve të LDK-së, duke e urdhëruar që mos ti paraqes pa rregullsitë e anëtarëve të PDK-së. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se janë shkelur dispozitat e nenit 33 pika g) dhe nenit 34.2 e LZP-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga PDK-ja pretendohet se gjatë procesit të votimit në VV me nr. 0101C, deputetja e Kuvendit të Kosovës Safete Hadërgjonaj e ka kërcënuar verbalisht koordinatoren e vëzhguesve të LDK-së, duke e urdhëruar që mos ti paraqes pa rregullsitë e anëtarëve të PDK-së.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, sepse për shkak të mungesës së provave shkelja e supozuar nga parashtruesi i ankesës nuk u vërtetua, me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 548/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

